



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.853/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rrustem Thaqi dhe Zyhdi Haziri anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Hajdin Ademi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet pjesërisht** i bazuar apeli Anr.853/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, Hajdin Ademi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Vitisë, nga radhët e subjektit politik nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë, në vendvotimet VV 2617D/04D në fshatin Smirë, VV 2605D/04R në fshatin Pozheran, VV 2605D/05D në fshatin Pozheran, VV 2633D/02D në fshatin Sadovinë e Çerkezve dhe vendvotimin VV 2625D/01D në fshatin Terstenik.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrat e Votimeve, të vendosura si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

**IV Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.853/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, Hajdin Ademi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, në pjesën me të cilën ka kërkuar rinumërimin e vendvotimeve VV 2630D/01R.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, Hajdin Ademi, me të cilin pretendon se në vendvotimet 2617D/04D i ka gjithsej 2 vota derisa ishte dashur t'i kishte 3 vota, në vendvotimin 2605D/04R ku kanë votuar familjarë të tij i mungojnë edhe 3 vota, në vendvotimin 2605D/05D pretendon se i mungojnë 3 vota, në vendvotimin 2603D/01D pretendon se i

mungon një votë, në vendvotimin 2633D/02D pretendon se i mungojnë 3 vota dhe në vendvotimin 2625D/01D pretendon se i mungojnë 2 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është pjesërisht i bazuar.**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, Hajdin Ademi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të urdhëron rinumërimin e fletëvotimeve në VV 2617D/04D, VV 2605D/04R, VV 2605D/05D VV 2633D/02D dhe VV 2625D/01D.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket Vendvotimeve, të vendosura si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, ngase ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve në këto vendvotime, ashtu që edhe pasi verifikoi listën e vendvotimeve të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) konstatoi se në vendvotimet e cekura si në dispozitiv apeluasi ka gjithsej 10 vota, në Formularët e Rezultateve të Kandidatit i njëjti ka gjithsej 10 vota, nga e cila rrjedh se apeluasi nuk ka 13 vota ashtu siç pretendon në apelin e parashtruar prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar, ndaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për qendrat e votimit e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerëson se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, Hajdin Ademi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë kërkon rinumërimin e votave për vendvotimin VV 2630D/01R, është i pa bazuar për faktin se për të njëjtin vendvotim, KQZ-ja veç ka marrë vendim për rinumërim para se rezultati përfundimtar të publikohet andaj të njëjtat janë të rinumëruara, për këto arsye paneli vlerëson se një rinumërim tjetër për të njëjtin vendvotim të rinumëruar nga KQZ-ja në QNR, është i pa arsyeshëm, për më tepër ankuesi nuk ka ofruar prova shkresore që do ta

argumenton se parregullsitë kanë ndodhur me rastin e rinumërimit andaj si të tilla këto pretendime janë të paqëndrueshme.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.853/2021 më datën 07.11.2021**

**Kryesues i Panelit**  
**Adrian Konushevi**



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.